

## **Metodologjia e leximit të fatkeqësive (në veçanti me rastin e virusit Corona)**

Në fillim i shpreh ngushëllimet e mia vendit tonë, popullit tonë dhe mbarë njerëzimit! Uroj që sa më shpejtë të shpëtojmë nga kjo sëmundje ngjitëse që na ka kapluar! Atyre që kanë ndërruar jetë, uroj që All-llahu xh.sh. t'i ketë mëshiruar! Lutem, si gjithnjë, që Zoti ynë ta kaplojë me emrin e tij *esh-Shafi* (Shëruesi) mbarë njerëzimin! Uroj që në zemrat e dijetarëve të inspirojë shërimin e kësaj sëmundjeje! Uroj që me mëshirën e Tij të gjerë e të pafund të na largojë çdo frikë dhe shqetësim tonin!

Në institutin tonë shkencor, Instituti i Mendimit Islam, me studentët tanë më së shumti i trajtojmë temat që kanë të bëjnë me shkencat e metodologjisë. Fusha e specializimit në Institutin tonë është edhe metodologjia e të kuptuarit të Islamit si një tërësi, por edhe e metodologjisë në shkencat islame.

Sot, duke e marrë parasysh kohën e veçantë dhe të vështirë nëpër të cilën po kalojmë, dua ta trajtoj një metodologji krejt tjetër. Dëshiroj ta trajtoj temën e metodologjisë së leximit të fatkeqësive, të mynxyrave dhe të sëmundjeve.

Si duhet kuptuar fatkeqësitë e këtilla? A thua vërtet këto janë dënime nga Zoti, siç pretendojnë disa? Ose mos janë mëshirë, që ne nuk e njohim? A thua mos është ky kijameti (fundi i botës), siç pretendojnë disa të pamatur? Apo mos janë një shenjë dhe një *ibret* (mësim, leksion)? Libri ynë i të gjitha kohërave, Kur'ani fisnik, çfarë thotë për këto çështje? Cilat janë këshillat dhe rekomandimet e Pejgamberit tonë të dashur në këtë drejtim? Ja pra, në mësimin tonë të sotëm metodologjik do të mundohem në veçanti të jap përgjigje për këto pyetje.

Po, sot njerëzimi ballafaqohet me një botë të re që nuk e ka shoqen në asnjë epokë të historisë. Njerëzimi për një kohë relativisht të shkurtër hyri në një botë të re. Ndoshta pas kësaj për historinë do të flitet duke e ndarë atë në para-koronës dhe pas-koronës. Brenda një kohe të shkurtër tremujore, një virus që u paraqit në qytetin Wuhan të Kinës, e mbërtheu pothuajse mbarë njerëzimin. Jeta erdhi deri në shkallën e ndaljes së plotë. Shtetet i mbyllën kufijtë e tyre. Transporti ka rënë në minimum. Jeta tregtare është ngadalësuar. Është pezulluar arsimimi, jeta fetare e adhurimeve të përbashkëta. Janë zbratur rrugët, sokaqet, qytetet. Njerëzit janë mbyllur në shtëpitë e tyre.

S'ka dyshim se njerëzimi nuk ballafaqohet për herë të parë me epidemi të këtilla. Historia e njerëzimit është e mbushur me fatkeqësi të këtilla. Nëse e shikojmë nga një këndvështrim tjetër, historia në fakt është historia e fatkeqësive, e urive, e thatësive dhe e sëmundjeve. Sa e sa qindra mijëra njerëz e kanë humbur jetën nga kolera, tuberkulozi, tifoja, influenca, SARS-i, AIDS-i etj.

Qysh në fillim të historisë islame, në kohën e hz. Omerit, vdiqën 25 mijë njerëz, ndër ta edhe dhjetëra *sahabi* (shokë të Pejgamberit a.s.) të dalluar, nga murtaja e Amvasit. Në fillim të shekullit të kaluar, gjatë Luftës së Parë Botërore, kontinenti i Evropës e humbi një të tretën e popullsisë së tij vetëm nga sëmundjet ngjitëse.

Asnjëra prej tyre nuk i ngjanë kësaj që po e përjetojmë sot. Asnjëra prej atyre që kanë ndodhur përgjatë historisë nuk është shndërruar në epidemi globale. Po, bota sot ballafaqohet me një pandemi, e cila mbarë njerëzimit ia ka futur frikën dhe shqetësimin. Mbarë njerëzimit e ka kapluar brenga për një të ardhme të pasigurt.

Për më tepër, të gjitha këto janë duke ndodhur në një kohë kur njeriu është më i fuqishëm se kurrë. Ndodhin në një kohë të revolucionit të dijes, të shkencës, të teknologjisë, të komunikimit dhe në një kohë të prodhimit të armëve kimike të cilat janë në gjendje ta shkatërrojnë mbarë botën. Ndodhin në një kohë kur njerëzimi, me anë të nano-teknologjisë, planifikon një të ardhme të re. Ndodhin në një kohë kur mjekësia dhe industria e farmacisë kanë arritur kulmin e tyre, kur po hulumtohen rrugët e pavdekësisë, kur po gjurmohen fushat për jetesë në hapësirë, në kozmos. Dhe, në një kohë kur mendjemadhësia, harbimi e lazdrimi enden në mënyrë të pafrenuar, një virus që mund të shihet vetëm me mikroskop, thuhet se ka mbërthyer jetën e mbarë njerëzimit. Të gjithë ne jemi mbyllur në shtëpitë tona dhe e presim epilogun e panjohur.

Ministria e Shëndetësisë, personeli shëndetësor, mjekët, autoritetet mjekësore, janë duke i kryer me ndershmëri detyrat e tyre. All-llahu qoftë i kënaqur me ta! Ata na shpjegojnë hollësisht se si të kemi kujdes për pastërtinë dhe si duhet t'i ndjekim kushtet e karantinës.

Mjetet e komunikimit masiv, rrjetet e mediave sociale, për çdo moment i shpërndajnë informacionet e çdo ngjarjeje, kudo që të ndodhin ato, nga Kina e deri në Itali, nga Irani e deri në SHBA.

Mirëpo, një gjë po lihet anësh. Madje një gjë shumë e rëndësishme. Akoma nuk ka filluar të diskutohet sa duhet dimensionin njerëzor, social dhe shoqëror i kësaj çështjeje. Akoma nuk kanë filluar të shkruhen artikuj e libra për dimensionin shpirtëror, metafizik, të kësaj pune. Ndërkaq tanimë ka kaluar koha që këtë të mos e trajtojmë vetëm si një problem shëndetësor.

Ashtu si në shumë çështje të tjera, njerëzimi edhe këtu do të ndahet në mendime. Njerëzit e shkencës, filozofët, njerëzit e fesë, secili prej tyre do ta vlerësojë këtë çështje nga këndvështrimi i vet. Në vend që këtë ta shikojmë vetëm nga një këndvështrim, rezultate më të mira do të mund të arrinim sikur kësaj t'i qasemi me një metodë holistike, gjithëpërfshirëse.

Sepse shkencën këtë çështje e shpjegon, filozofia të çon të mendosh rreth saj, kurse feja i jep kuptim. Kuptimin që ia jep feja, nuk e shpërfill shpjegimin e shkencës e as mendimin e filozofisë. Sepse shkencën është *tefsiri* (komentuesi, shpjeguesi) i ajeteve dhe shenjave që Zoti i ka vënë në gjithësi; ndërsa arsyeja dhe të menduarit janë mirësitë më të mëdha që Ai ia ka dhënë njeriut.

Mundja e frikës, largimi i shqetësimeve, tejkalimi i frikës nga vdekja, madje - ashtu siç shprehet një poet - edhe mbytja e vdekjes, përgjatë historisë ka qenë e mundshme vetëm me anë të kuptimeve të larta që i ka dhënë feja.

Edhe sot, pa mos e mohuar shkencën dhe arsyen, me kuptimet që na ofron feja islame ne mund t'u japim kuptim këtyre që jemi duke i përjetuar.

Më herët, kur ka munguar udhërrëfimi i shpalljes apo i zbulesës hyjnore, njerëzimi ka tentuar që fatkeqësitë dhe mynxyrat që i kanë rënë në kokë t'i sqarojë herë vetëm me besëtytni e hajmali e herë vetëm me astrologji. Shumë herë madje këto i ka lidhur ose me luftën ose me zemërimin e perëndive. E ndonjëherë faji u është hedhur njerëzve që janë quajtur të pafat e të kobshëm. Shpallja hyjnore, e cila i bashkon dhe i trajton njësoj krijimtarinë e Zotit me Fjalën e Zotit, edhe në këtë çështje ia ka treguar njerëzimit rrugën e drejtë që do ta shpëtojë atë nga çdo lloj besimi i kotë dhe besëtytnie.

Nëse Shpalljen e Zotit e marrim në tërësinë e saj; nëse i trajtojmë bashkë dhe njëkohësisht njeriun, shpalljen dhe gjithësinë, atëherë do të kuptojmë se këto mynxyra e fatkeqësi në radhë të parë nuk janë adete apo zakone të Zotit, porse ajete apo shenja të Tij.

Ato nuk janë dënime, siç pretendohet disa herë me zemërim. Në Kur'an All-llahu xh.sh. thotë:

وَلَوْ يُؤَاخِذُ اللَّهُ النَّاسَ بِمَا كَسَبُوا مَا تَرَكَ عَلَى ظَهْرِهَا مِنْ دَابَّةٍ وَلَكِنْ يُؤَخِّرُهُمْ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّىٰ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِعِبَادِهِ بَصِيرًا.

*“E sikur All-llahu t'i kapte (t'i dënonte) njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në momentin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, s'ka dyshim se All-llahu i ka parasysh robërit e vet.” (Fatir, 35:45)*

Në një sure tjetër ndërkaq thotë:

وَمَا رَبُّكَ بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ.

*“... e Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve.” (Fussilet, 41:46)*

Ato nuk paraqesin as edhe fundin e kësaj bote (kijametin), siç pretendojnë disa që nuk e njohin veten mirë. Ngase dija dhe informacioni për kijametin nuk i është dhënë asnjë pejgamberi. Dija për shenjat e tij nuk nënkupton edhe dijen për vetë kijametin.

Sipas Kur'anit, kjo fatkeqësi që na ka rënë në kokë, është një ajet. Kuptimi gjuhësor i fjalës “ajet” është “shenjë”. Secili besimtar nxjerr *ibret*, mësim të ndryshëm nga kjo shenjë. Shenjat, nuk lexohen me anë të shprehjeve, por me anë të *ibreteve*. Urdhri në vijim i All-llahut e ka pikërisht këtë për qëllim, kur thotë:

فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ.

*“... pra merrni mësim (ibret), o ju të zotët e mendjes!” (el-Hashr, 59:2)*

Përveç kësaj, madje as edhe tufanin e Nuhit a.s. Kur'ani nuk e quan fatkeqësi, por shenjë:

وَجَعَلْنَاهُمْ لِلنَّاسِ آيَةً ...

*“... dhe njerëzve ua bëmë ajet (këshillë, mësim) ...” (el-Furkan, 25:37)*

Kur kjo fatkeqësi të lexohet si një ajet, si një shenjë hyjnore, disa arsye e kësaj do ta kërkojnë te shfrytëzimi i papërgjegjshëm i natyrës nga ana e njeriut. Disa do të thonë se kjo botë nuk është më në gjendje ta bartë e ta durojë njeriun. Disa këtë do ta lidhin me tragjeditë njerëzore që po ndodhin prej vitesh në Arakan, në Turkistanin Lindor (Kinë), në Siri, në Jemen. Disa mbylljen e kufijve shtetërorë do ta lidhin me mbylljen e të njëjtëve kufij për refugjatët sirianë. Disa këtë do ta lidhin me konfliktet globale që po zhvillohen në kurriz të popullit të përvuajtur sirian. Disa të tjerë arsye për këtë do ta kërkojnë te kufomat e fëmijëve të përplasur në brigjet e Mesdheut. Disa këtë do ta lidhin me harresën e vetvetes, të familjes, të shpirtit, të Zotit, në këtë kohë të kënaqësive e të shpejtësive marramendëse. Mbylljen tonë nëpër shtëpi disa do ta lidhin me neglijencën dhe shpërfilljen që ne ia kemi bërë bashkëshortit/es, familjes, fëmijëve tanë. Disa besimtarë mbylljen e dyerve që po na bënë Qabeja, Xhamia e Pejgamberit a.s. në Medine, Xhamia Aksa në Jerusalem, xhamitë dhe xhumatë tona, do ta lidhin me lënien pas dore të tyre nga ana jonë, me lënien e tyre në duar të të huajve. Disa besimtarë këtë do ta lidhin me pamundësinë e faljes së mëkateve tona nga njëra umre në tjetrën, nga njëri haxh në tjetrin, nga njëra xhuma në tjetrën. Disa këtë do ta lidhin me mallkimin e fëmijëve të Afrikës, të cilët prej vitesh vdesin nga uria. Disa mbylljen tonë në

karantinë do ta lidhin me rrethimin e padrejtë prej dekadash të Gazës. Dikush arsyen e kësaj do ta kërkojë te braktisja e ushqimeve të pastra e të lejuara (*hallall*) me të cilat na ka furnizuar All-llahu xh.sh.

Në qoftë se të gjitha këto që na vijnë mbi kokë i vlerësojmë si shenja, atëherë të gjitha këto kuptime që i përmendëm janë të drejta. Dhe kemi bindjen se kjo hartë e kuptimeve të begata do ta çojë njerëzimin të mendojë edhe një herë më mirë për vetveten, se do ta çojë atë drejt një mëshire e dhembshurie të re.

Në qoftë se këto lexohen në këtë mënyrë, atëherë njeriu do të ballafaqohet me vetveten. Njeriu do t'i rishqyrtojë raportet e tij me botën, me natyrën. Do t'i rregullojë raportet me bashkëshorten/tin, me miqtë, me familjen. Ta lësh mënjanë këtë botë të kuptimeve të pasura pafundësisht dhe këto lloj fatkeqësish t'i lidhësh me një person, me një ngjarje, me një shoqëri të caktuar dhe t'i shpjegosh ato me dënimin e Zotit dhe me kijametin, nënkupton mungesën e aftësisë së të kuptuarit të drejtë të ajeteve të pafund. Kjo na shkëput ne nga *ibreti*, nga mësimi, dhe na mbyll në shprehje të thata. Kjo nuk na i zgjidh problemet, përkundrazi na i thellon krizat.

Pengesat që na vështirësojnë të kuptuarit e drejtë të këtyre fatkeqësive nën dritën e shpalljes hyjnore janë me sa vijon:

*E para*, interpretimi i këtyre ngjarjeve në një mënyrë a formë që e ngre dhe e pezullon përgjegjësinë e njeriut. Ndërkaq All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ ...

*"Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza e crregullime..."* (er-Rum, 30:41)

*E dyta*, lënia anësh e Krijuesit të gjithësisë kur interpretohen këto ngjarje. T'i lexosh dhe t'i interpretosh këto ngjarje duke mos e marrë në konsideratë Zotin dhe ligjet që Ai i ka vënë në gjithësi, do të ishte gabimi më i madh i mundshëm.

*E treta*, kur njeriu e vë veten në pozitën e Zotit. Kur ai flet në emër të Tij. Kur themi se kjo që po ndodh është dënim i Zotit që ia jep filan shoqërisë për këtë e atë arsye, është e barabartë sikur të flasësh në emër të Zotit. Dhe kjo nuk është e drejtë dhe s'është e vërtetë.

*E katërta*, mohimi i shkaqeve dhe i pasojave që i ka krijuar Zoti. Të mos marrësh masat e nevojshme kundër fatkeqësive. Duhet ditur mirë se sidomos në raste të sëmundjeve të këtilla epidemike rekomandimet e autoriteteve shëndetësore janë edhe rekomandime fetare. Feja islame mbrojtjen dhe sigurinë e jetës e ka proklamuar si bazamentin më të madh fetar.

Pejgamberi a.s. para 14 shekujsh i ka përcaktuar në mënyrën më të mirë parimet e karantinës për sëmundjet ngjitëse të asaj kohe. Ai ka thënë: *"Një të sëmurë mos e çoni te i shëndoshi!"*. Po ashtu ka thënë: *"Në qoftë se në një vend është përhapur murtaja, mos shkoni atje! E nëse ndodheni atje, mos dilni që aty!"*. Kur hz. Omeri nuk hyri në Sham (Damaskun e asaj kohe) për shkak të murtajës që kishte shpërthyer atje dhe u kthye prapë, guvernatori i tij atje, Ebu Ubejde bin el-Xherrahu, i tha: *"A po ik nga caktimi i Zotit, o Omer?"*, ky iu përgjigj: *"Iki nga caktimi i Zotit në caktimin tjetër të Zotit."*

Masat që duhet t'i marrim kundër kësaj sëmundjeje ngjitëse mund t'i ndajmë më tresh:

*E para*, ashtu siç thamë pak më parë, është urdhër dhe imperativ fetar ndërmarrja e të gjitha masave të mundshme të kohës për pengimin e shtrirjes së infektimit. Qëndrimin tonë në shtëpi mund ta kthejmë në një mundësi të re të rizbulimit të dashurisë familjare. Mbetjen tonë larg xhamive mund ta kthejmë në shans të shndërrimit të shtëpive tona në faltore.

*Masa e dytë* është që shkencëtarët të mundohen ta gjejnë shërimin e kësaj sëmundjeje. Gjetja e një çareje, e një zgjidhjeje, për këtë sëmundje është shkalla më e lartë që mund ta arrijë njeriu. Njerëzimi duhet ta braktisë garën në prodhimin e armëve për ta vrrarë njëri-tjetrin dhe të mundohet të krijojë zgjidhje për dertet dhe problemet e njëri-tjetrit.

Dhe *zgjidhja e madhe e fundit* është lutja, lutja, lutja. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِّن قَبْلِكَ فَأَخَذْنَاهُم بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ لَعَلَّهُمْ يَتَضَرَّعُونَ ﴿٤٢﴾ فَلَوْلَا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَكِنْ قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ.

*“Ne kemi dërguar (pejgamberë) edhe te popujt para teje (e derisa nuk dëgjuan), i dënuam me skamje e mjerim, ashtu që të përulen. E pse të mos përuleshin kur u erdhi atyre dënimi ynë? Por zemrat e tyre ishin ngurosur, po edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin.”* (el-En'am, 6:42-43)

Sigurisht që është shumë me rëndësi në këtë kohë t'i ngremë duart dhe t'i drejtohem me lutje për strehim dhe ndihmë All-llahut Fuqiptotë. Për çdo ditë duhet të gjejmë nga një moment të caktuar kur bashkërisht me të gjithë anëtarët e familjes do t'i lutemi Zotit për ndihmë.

Megjithëkëtë, lutja më e mirë është lutja aktive. Nga sot lutjet tona le t'i kthejmë në një lëvizje të madhe bamirësie. Në këto kohë të vështira që po kalojmë, t'ia paguash qiranë e banesës apo të punëtorisë një qiraxhiu që vetë s'mund ta bëjë këtë, është lutja më e madhe. Ti si punëdhënës t'ia paguash rrogën e plotë punëtorit tënd që në këtë kohë nuk mund të vijë në vendin e punës, është lutja, duaja më e madhe. Të bësh pazar për fqinjin tënd të pamundur, është lutja më e madhe. Lutja më e madhe për ta fituar mëshirën hyjnore dhe për t'i larguar dëmet e fatkeqësitë, është nisja e një lëvizjeje të madhe bamirësie në këto kohë të vështira. Është mirësia që ne mund t'ia bëjmë njëri-tjetrit. Pamundësinë e përshendetjes për dore ne pa problem mund ta kthejmë në takim dhe në shtrëngim të zemrave tona.

Po e përfundoj shkrimin tim me lutjen e pejgamberit Ejjub a.s.:

أَيُّ مَسْنِي الضُّرِّ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ...

*“Më ka gjetur belaja, mirëpo Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”* (el-Enbija', 21:83)

Nga turqishtja:  
Rejhan Neziri